



Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, njofton:

THIRRJE PUBLIKE PËR TË GJITHË INDIVIDËT E PAPUNË, SI DHE TË RINJTË (15 – 29 VJEÇ) DHE GRATË PËR TË MARRË PJESË NË TRAJNIME NË VENDIN E PUNËS NË SEKTORËT TURIZËM DHE MIKPRITJE, ICT DHE SEKTORË TË TJERË TË NDËRLIDHUR, ME QËLLIM RITJEN E PUNËSIMIT

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton të gjithë individët e papunë, si dhe të rinjtë (15 – 29 vjeç) dhe gratë që banojnë në bashkitë: Bashkia Shkodër, Bashkia e Vaut të Dejës, Bashkia e Malësisë së Madhe, të aplikojnë për pjesëmarrje në trajnimet në vendin e punës në sektorët turizëm dhe mikpritje, ICT dhe sektorë të tjerë të ndërlidhur, me qëllim rritjen e punësimit.

Trajnimet në vendin e punës janë një mundësi afatshkurtër për individët e papunë në zonën ndërkufitare për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale, për të fituar përvojë dhe për të kuptuar më mirë detyrat e një vendi të caktuar pune.

Trajnimi në vendin e punës do të zgjasë 3 muaj dhe pas përfundimit me sukses të trajnimit individi do të pajiset me një certifikatë trajnimi në punë.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Për realizimin e këtij aktiviteti, projekti parashikon një fond total prej 20,250.00€, ose 450.00€ në muaj për person për rimbursimin bruto të të gjitha shpenzimeve të trajnimit në vendin e punës.

Programi do të zbatohet për 15 pjesëmarrës gjithsej, ndërsa dinamika dhe realizimi i trajnimit do të përcaktohet në bazë të numrit të aplikimeve për pjesëmarrje në trajnim.

Ju duhet të konfirmoni interesin tuaj për të marrë pjesë në trajnim duke plotësuar formularin e aplikimit në [Link](#) më **03 korrik 2023 në orën 16:30**.

Së bashku me formularin e aplikimit është e nevojshme të bashkëngjitni dëshmi të arsimit të përfunduar profesional (diplomë) ose çdo lloj formimi profesional, si dhe certifikatë për paaftësi të mundshme për të punuar (nëse keni).

Kandidatët e përzgjedhur do të informohen në kohë për dinamikën e trajnimit.

Të gjitha pyetjet në lidhje me këtë thirrje mund të dërgohen me e-mail në: info@aida.gov.al.

Inkurajojmë të gjithë individët e papunë, si dhe dhe të rinjtë dhe gratë që të regjistrohen sa më shpejt për të siguruar pjesëmarrjen në këtë trajnim.

Tiranë, 19.06.2023



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

FORMULAR APLIKIMI

Afati për të dorëzuar aplikimin tuaj është data **3 Korrik 2023, ora 16:30**

1.	Emri dhe Mbiemri	
2.	Adresa	
3.	Datëlindja	
4.	Gjinia	
5.	E-mail	
6.	Niveli i edukimit	
7.	Roli për të cilin po aplikoni	

Vendi dhe data e aplikimit:

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës:



Funded by
the European Union

